

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Menaxhment Programi: Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit
Titulli i lëndës:	Zhvillimi i Inovacionit Personal
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Semestri:	III
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Ky modul do të iu ofroj mundësi studentëve të mesojnë njohuritë teorike dhe zhvillimin e aftësive praktike në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë inovative në organizatat moderne, duke filluar nga Konceptet bazë të zhvillimit të inovacionit, Inovacionet, kreativiteti dhe ndermarresia, organizimi i inovacioneve dhe ndermarrësisë. Ndermarresia korporative, menaxhimi strategjik i inovacionit, zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja, financimi i ideve ndermarrese inovative, çmimet e inovacioneve, rritja e firmave dhe inovacioneve, inovacionet firma dhe struktura e tregut, rregulloret e veprimtarisë inovative, menaxhimi i projekteve të inovacionit, rreziqet e projekteve të inovacionit, etj.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është t'u ofrojë studentëve një qasje kritike të kreativitetit dhe inovacioneve në organizatë, të inkurajojë studentët në procesin e krijimit të ideve të reja (produkteve, shërbimeve apo edhe mënyrave të reja të zgjidhjes së problemeve), të përmirësojnë aftësinë e tyre për të menduar në mënyrë kreative, të eksplorojnë konceptin e menaxhimit të inovacionit si të menaxhohet inovacioni i produktit dhe të ndërtohet konkurrueshmëria përmes inovacionit, të demonstrojnë njohjen e instrumenteve qeveritare për mbështetjen e inovacioneve.</p>
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analizon procesin ndërmarrës dhe inovativ dhe mënyrën e operimit të firmave ndërmarrëse. 2. Nderton aftësinë për të udhëhequr organizata inovative 3. Aplikon teknikat e gjenerimit të ideve inovative dhe të menduarit kreativ në zgjidhjen e problemeve në organizatë. 4. Demonstrone aftësi analitike në rolin e mjedisit organizativ në promovimin e inovacioneve brenda organizatës. 5. Interpreton në mënyrë kritike politikat qeveritare lidhur

	<p>me inovacionet.</p> <p>6. Kultivon aftësinë për t'u organizuar dhe menaxhuar zbatimin e strategjisë inovative</p> <p>7. Zbaton metoda efektive të strategjisë së formulimit të inovacionit organizativ</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrimet teorike/detyra			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet			
Ushtrime në terren			
Kollokuium – seminar			
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			25
Përgatitja përfundimtare në provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1	5
Projektet, prezantimet etj	1	10	10
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	<p>Ligjëratat do të organizohen duke pasur studentin në qendër, do të dëgjohet opinioni i studenteve për literaturën që do të përdoret, për mënyrën e organizimit të ligjërates e cila do të jetë e koordinuar me studentët për diskutime interaktive lidhur me temat e ligjëruesve duke marrë raste studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, angazhim për studentin për të prezantuar njohuritë e fituara gjatë ligjërates dhe prezantimi i punimeve/projekteve ndërlidhur me materialin e përpunuar.</p>		
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	<p>Vlerësimi dhe forma e ndërtimit të notës për studentet do të mbështetet në tre aktivitetet e mëposhtme:</p> <p>1. Aktiviteti dhe angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme,</p> <p>Aktiviteti në mësim - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjërates.</p> <p>Angazhimi - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjërate dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërates vijuese.</p> <p>2. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët e</p>		

	<p>mundshme, Brenda semestrit studenti (mund te jete një grup i studenteve – jo me shume se 3 studente) duhet te përgatit një detyre, projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Tema e punimit mund te propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet te jete ne korrelacion te plote me lenden.</p> <p>3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë nga 100 pikët e mundshme, Studenti ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit te provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit. Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies se parapare për materialin e lendes se ligjruar. Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet ne mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyetje objektive, te njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës, • pyetje subjektive te llojit ese/detyre me shkrim për te cilat vete studenti duhet te jete ne gjendje te jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lendes se ligjruar, te njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit. <p>Studentët pasi i nënshtrohen provimit, do të ndërtojnë notën përfundimtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • max 10 pikë - aktiviteti dhe angazhimi në mësim, • max 20 pikë- hartimi dhe prezantimi i detyrës, projektit, punimi/hulumtimit, • max 70 pikë - provimi final (ose nga dy testet), <p>Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë nga te gjitha kriteret e vlerësimit,</p>
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% Teori, 30% Ushtrime,
Literatura	
Literatura bazë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Trott, P (2008) Innovation Management and New Product Development, Prentice Hall 2. Vinnie Jauhari, SudanshuBhushan, Innovation Management,

	Oxford Higher Education, 2014.
Literatura shtesë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Henry, J (2006) Creative Management and Development, Sage Publications Ltd. 2. Proctor, T (2005) Creative Problem Solving for Managers, Routledge
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	<p>Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës; Konceptet dhe përkufizimet bazë të zhvillimit të inovacionit; Është ligjëratë hyrëse, studentët do të njoftohen me planprogramin e lëndës; shfaqjen, krijimin dhe tiparet kryesore të menaxhimit të inovacionit; Inovacioni si objekt menaxhues, përcaktimi, rëndësia, funksionet, cikli jetësor i inovacionit, etj. Rezultati i pritur nr. 1</p>
Java e dytë	<p>Inovacionet; Në këtë ligjëratë studentët do të njihen me rëndësinë dhe natyrën e Inovacioneve dhe të menduarit kreativ. Definimin e Inovacionit. Rëndësia e Inovacioneve në ekonominë e diturisë. Llojet e Inovacioneve. Invencioni vs Inovacioni. Procesi i Inovacionit. Rezultati i pritur nr.1 dhe 6.</p>
Java e tretë	<p>Kreativiteti, inovacionet dhe ndërmarrësia. Gjatë këtij leksioni do të kemi ushtrime dhe ligjerata, ku pasqyrohet Relacioni në mes Kreativitetit, Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Roli i diturisë në nxitjen e Inovacioneve. Struktura Organizative dhe ndikimi në menaxhimin e inovacioneve. Rezultati i pritur nr.1,2 ,4 dhe 6.</p>
Java e katërt	<p>Organizimi i inovacioneve dhe ndërmarrësia. Në këtë ligjëratë do të kemi përsëritje të ligjëratave të zhvilluara duke u nderlidhur me Kuptimin e kreativitetit, Promovimi i kreativitetit individual (personal), Procesi i inovacionit, Barrierat në zhvillimin e kreativitetit dhe inovacioneve, Gjenerimi dhe vlerësimi i ideve, Transformimi i ideve në mundësi reale për komercializim, etj. Rezultati i pritur nr.1,2,3, 4 dhe 6.</p>
Java e pestë	<p>Ndërmarrësia korporative dhe inovacionet Në këtë ligjëratë do të kemi ushtrime dhe ligjërata duke vazhduar me Organizatën dhe kreativitetin individual (personal), Promovimi i kreativitetit dhe inovacioneve brenda organizatës. Mjedisi organizativ dhe inovacionet, Barrierat në promovimin e sjelljes ndërmarrëse dhe inovative të menaxherëve dhe punëtorëve. Rezultati i pritur nr. 1,2,3,4 dhe 7.</p>
Java e gjashtë	<p>Menaxhimi strategjik i inovacionit Në këtë ligjëratë do të zhvillohet mësim interaktiv për ndërmarrësinë dhe inovacionin duke i dhënë hapësirë diskutimeve individuale të studentëve dhe duke shkoqitur mëtej konceptin e menaxhimit strategjik në sferën e inovacionit, karakteristikat dhe zgjedhja e strategjisë, qëllimi dhe modeli i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit të inovacionit, teknikat e kontrollit optimal, konceptet bazë të teorisë së vendimmarrjes, problemet e klasifikimit të zhvillimit të strategjive innovative, etj.</p>

	Rezultati i pritur nr.1,2,3,4,6, dhe 7.
Java e shtatë	Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja. Në këtë ligjëratë nga studentët do të kërkohet mendim për ecurinë e ligjëratave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim duke ndërlidhur me zhvillimin e produktit kundrejt shërbimeve. Strategjitë e zhvillimit të produkteve të reja. Organizmi i procesit të zhvillimit të produktit të ri. Instrumentet dhe teknologjia mbështetëse për produkte dhe shërbime të reja. Rezultati i pritur nr.2,3,4,6, dhe 7.
Java e tetë	Financimi i ideve ndërmarrëse/inovative. Gjate ketij leksioni do te kemi ushtrime, e përsëritje duke u kyqur në Problemet e financimit të inovacioneve. Qasja në burimet eksterne të financimit, Informimi asimetrik dhe qasja në financim. Rezultati i pritur nr.2,3,5,6,dhe 7.
Java e nëntë	Çmimi i inovacioneve Ne kete ligjeratë do te kemi përsëritje te materialit të zhvilluar, për të vazhduar me Faktorët që ndikojnë në procesin e vendosjes së çmimeve; Qasja e menaxhimit të çmimeve; Procesi i vendosjes së çmimeve të një produkti inovativ; Metodot e çmimeve të projektit inovativ; Efiçenca ekonomike e inovacioneve dhe metodat e analizës së saj. Rezultati i pritur nr.1,2,3,4,5, 6 dhe 7.
Java e dhjetë	Rritja e firmave dhe inovacionet Ne kete ligjeratë do te kemi ushtrime dhe ligjërata për t’u ndërlidhur me ndikimin e karakteristikave të individit, firmës dhe mjedist në rritjen e firmave, Modelet e rritjes së firmave. Inovacionet dhe përparësitë konkurruese të firmës. Rezultati i pritur nr.1,2,3,4,6,dhe 7.
Java e njëmbëdhjetë	Inovacionet, firma dhe struktura e tregut. Në këtë ligjëratë do të ketë diskutime interaktive për materialin e lëndës se përpunuar për të vazhduar me Inovacionet, firmën dhe strukturën e industrisë, Ekonomia e shkallës dhe gjenerimi i inovacioneve, Ndikimi i strukturave të tregjeve në motivet për investime në inovacione të firmave. Rezultati i pritur nr. 1,2,3,6 dhe 7.
Java e dymbëdhjetë	Rregulloret e veprimtarisë së inovacionit Gjate ketij leksioni do te kemi ushtrime dhe ligjerata duke vazhduar me Konsideratat rregullatore, Rregulloret shtetërore të veprimtarisë së inovacionit, Metodot e zbatimit, Patentat Licencat dhe motivet për investime në inovacione, Mbështetja e bizneseve të reja dhe inovacioneve. Klima ndërmarrëse, si dhe do të bëhet prezantimi i projekteve nga studentët. Rezultati i pritur nr.2,4,5,6 dhe 7.
Java e trembëdhjetë	Menaxhimi i projektit të inovacionit Në këtë ligjëratë do te kemi përsëritje te materialit te zhvilluar, për t’u kyqur në Klasifikimin e projekteve të inovacionit, Zhvillimi i programeve dhe projekteve, Karakteristikat e menaxhimit të projekteve të inovacionit, Hulumtimi dhe zhvillimi i projektit të inovacionit, Qasja e inovacionit me përfshirje të lartë., si dhe do te vazhdohet me prezantimin e projekteve te paracaktuara nga

	studentët. Rezultati i pritur nr.1,2,4,5,6 dhe 7.
Java e katërbëdhjetë	Rreziqet e projekteve të inovacionit Në këtë ligjëratë do të kemi ushtrime e përsëritje të materialit të zhvilluar duke vazhduar me klasifikimin e rrezikut, Rreziqet kontabël në projekte, Metodatat për të reduktuar ndikimin e rreziqeve; Kushtet e kthimit të investimit, norma kontabël e kthimit, vlera aktuale neto, norma e brendshme e kthimit për të vazhduar me prezantimin e projekteve nga studentët. Rezultati i pritur nr.1,2,3,4,5,6 dhe 7.
Java e pesëmbëdhjetë	Rikapitullimi i materialeve; Prezantimet përfundimtare të projektit Rezultati i pritur nr.1,2,3,4,5,6 dhe 7.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studenti është i obliguar t'i vijoje ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.</p>	